



Pranuar / Dorezuar Priljeno/Prodato Received/Delivered	20 . 11 2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinitca Org./Unit	Nr Prot Bil Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKIMSHKEL	7033/2023		117



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1215/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Jeton Koca dhe Ardita Haxhnikaj Demi-anëtarë me Çlirim Zeka-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1215/2023 të datës 27.09.2023, të parashtruar nga ankuesja [redacted] të cilën me autorizim e përfaqëson avokat [redacted] me adresë rr. "Bardhyl Qaushi" hyrja E kati përdhese nr.1 Komuna e Prishtinës, kundër Njoftimit të Komisionit Vlerësues të datës 28.08.2023 të Komunës së Prishtinës, në çështjen juridike "Kontestim Konkursi", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 17.11.2023, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1215/2023 e datës 27.09.2023 e parashtruar nga ankuesja [redacted]

MBETET në fuqi Njoftimi i Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë i datës 28.08.2023 i Komunës së Prishtinës.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr vendimin me numër A.nr.631/2023 me datë 09.06.2023 me numër protokolli 4663/2023 me të cilin ka Aprovuar ankesën A.nr.631/2023 e datës 12.04.2023, e parashtruar nga ankuesja [redacted] dhe [redacted]

Anulohet Konkursi për pranim me nr. Reference RN00011416 me emrin e grupit Specialist të marrëdhënieve me publikun për informim-“Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun” i shpallur me datë 06.04.2023 nga Komuna e Prishtinës, si dhe çdo veprim tjetër administrativ që rrjedhë nga kjo procedurë e pranimit. Anulohet Vendimi i datës 31.03.2023 i Komisionit të Vlerësimit, Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 23.03.2023 si dhe Njoftimi i datës 31.03.2023 për përfundimin e procedurës së lëvizjes brenda kategorisë me numër reference RN0001101 për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun”. Mbetet në Fuqi Konkursi për Lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00011001, për pozitën e punës “Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun” në Komunën e Prishtinës si dhe Njoftimi për përzgjedhjen në listën e ngushtë i datës 13.03.2023, ndërsa çështja kthehet në fazën e vlerësimit të Komisionit për Vlerësim për lëvizje brenda kategorisë. Dhe Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Udhëheqësi i Njësisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II, III dhe IV të dispozitivit.

Me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.631/2023 të datës 09.06.2023, Kryetari i Komunës së Prishtinës ka nxjerr Vendim me numër 14-101/03-128609/2023 me datë 21.06.2023 me të cilin ka zbatuar vendimin e Këshillit A.nr.631/2023 të datës 09.06.2023 me numër protokolli 4663/2023.

Ankuesja [redacted] më datë 27.09.2023 ka parashtruar ankesë me numër protokolli 6277/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë të datës 28.08.2023 të Komunës së Prishtinës me pretendimin se nuk pajtohet me vlerësimin e bërë nga ana e Komisionit Vlerësues.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 04.10.2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Prishtinës, ndërsa Këshilli më datë 16.10.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Prishtinës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën e ankuesit me numër protokolli 3474/2023 të datës 12.04.2023 të parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Konkurs Lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00011001 i datës 14.02.2023; CV-ja e [redacted]; Aplikacionet nga HRMIS; Njoftim nga simbnj për [redacted] i datës 04.03.2023; Njoftim nga simbnj për [redacted] i datës 13.03.2023; Njoftim nga burimet njerëzore i datës 20.03.2023; Njoftim nga simbnj për [redacted] i datës 23.03.2023; Njoftim nga simbnj për [redacted] i datës 23.03.2023; Njoftim nga simbnj për [redacted] i datës 03.04.2023; Njoftim nga simbnj për [redacted] i datës 03.04.2023; Rezultatet e verifikimit paraprak të datës 13.03.2023; Rezultatet e vlerësimit të datës 22.03.2023; Rezultatet e vlerësimit të datës 23.03.2023; Rezultatet përfundimtare të vlerësimit të datës 03.04.2023;

Njoftim nga Njësia e Burimeve Njerëzore i datës 13.03.2023; Njoftim nga Njësia e Burimeve Njerëzore i datës 23.03.2023; Njoftim nga Njësia e Burimeve Njerëzore i datës 31.03.2023; Ankesë e ankueses drejtuar Komisionit të vlerësimit e datës 27.03.2023; Vendim i Komisionit Vlerësues për Lëvizje Brenda Kategorisë i Komunës së Prishtinës i datës 31.03.2023; Konkurs pranimit hapur me numër reference RN00011416 i datës 06.04.2023; Vërtetim për statusin e studentit me numër Ref.nr.04/3460 i datës 29.09.2020; Certifikatë e notave nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e me numër Ref.nr.04/3573 i datës 30.09.2020; Certifikatë e notave nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e me numër Ref.nr.04/3911 i datës 16.10.2020; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e me numër Nr.373 i datës 07.09.2016; Pasqyrë e notave nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e me numër Nr.prot.04/3514 i datës 30.09.2020; Diplomë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" e me numër Nr.2037 i datës 10.10.2013; Akt Emërimi i me numër Nr.11/04 i datës 21.01.2015; Ndryshimi dhe plotësimi i akt emërimit i me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 22.08.2022; Kontratë pune nga Universiteti "Ukshin Hoti" për me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 08.04.2021; Kontratë pune nga Universiteti "Ukshin Hoti" për me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 01.12.2020; Kontratë pune nga Universiteti "Haxhi Zeka" i datës 01.03.2018; Kontratë pune nga Universiteti "Haxhi Zeka" i datës 02.03.2017; Kontratë pune nga Universiteti "Haxhi Zeka" i datës 04.11.2016; Vërtetim pune nga gazeta "nacional" për me numër nr.11/04 i datës 27.11.2014; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 16.01.2023; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë të nëpunësve civil dhe nëpunësve të shërbimeve publike për kategorinë drejtues i mesëm, i ulët dhe profesional i me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 25.01.2022; Vërtetim nga Njësia e Burimeve Njerëzore e Komunës së Pejës për me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 01.03.2023; Certifikatë mbi dënimet penale e me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 01.03.2023; Certifikatë nga CDAEFF për me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 21.08.2016; Shkresë me titull rinia dhe punësimi e me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 15.11.2016; Certifikatë nga KAS për me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 25.03.2017; Certifikatë nga osce për me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 04.10.2017; Certifikatë nga EU për me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 21.07.2018; Certifikatë nga Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina" për me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 11.07.2019; Certifikatë nga Universiteti i Tetovës i me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 26.09.2019; Certifikatë nga qendra shqiptare e studimeve letrare "Pjeter Budi" për me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 03.09.2020; Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare, revistë nr. 39; Certifikatë nga IJSR për me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 06.06.2022; Kërkesë për përgjigje në ankesë përmes e-mailit e datës 10.05.2023; Përgjigje në ankesë e datës 17.05.2023; Njoftim nga Burimet Njerëzore i datës 20.03.2023; Vendim për themelimin e komisionit për vlerësim për lëvizje brenda kategorisë me numër 14-020/04-53705 i datës 13.03.2023; Lista e aplikantëve; Aplikacioni i me numër 14-020/04-53705 i datës 04.03.2023; Shkresë nga ICHSSA me numër ISBN:978-608-217-113-5 i datës 18.11.2022; Certifikatë nga Universiteti i Tetovës për me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 18.11.2022; Seminari XL ndërkombëtar për gjuhën letërsinë dhe kulturën shqiptare i datës 26.08.2022; Fotografi e me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 06.06.2022; Letërnjoftim i me numër Nr.01-112/01-0093784/22 i datës 23.03.2023; Vendim i Renditja përfundimtare e kandidatëve nga SIMBNJ i datës 23.03.2023; Vendim i KPMSHCK me numër VK/2023 i datës 26.05.2023;

Ankesën e ankuesit me numër protokolli 6277/2023 të datës 27.09.2023 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Autorizim nga për avokat ; Vendim i KPMSHCK me numër protokolli 4663/2023 i datës 09.06.2023; E-mail nga për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 07.08.2023; E-mail nga për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 09.08.2023; E-mail nga për ankesa.kpmschck@rks-gov.net i datës 07.08.2023; E-mail i datës 21.08.2023; E-mail nga Burimet Njerezore PR për i datës 23.08.2023; E-mail nga Simbnj për 28.08.2023; E-mail nga Simbnj për 28.08.2023; E-mail nga Simbnj për 31.08.2023; Njoftim nga sektori i burimeve njerëzore i Komunës së Prishtinës i datës 28.08.2023; Njoftim nga sektori i burimeve njerëzore i Komunës së Prishtinës i datës 31.08.2023; E-mail i datës 01.09.2023; Dëftesë për pranimin e dërgesës me nr. serik 205012023629532; E-mail i për Burimet Njerezore PR i datës 01.09.2023; E-mail i për Burimet Njerezore PR i datës 15.09.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 04.10.2023; Përgjigje në ankesë e datës 06.10.2023; Njoftim i datës 26.09.2023; Ankesë drejtuar Komisionit të Vlerësimit për Lëvizje Brenda Kategorisë në Komunën e Prishtinës e i datës 01.09.2023; Njoftim nga sektori i burimeve njerëzore i Komunës së Prishtinës i datës 13.03.2023; Renditja përfundimtare e kandidatëve nga Simbnj i datës 28.08.2023; Vlerësimet individuale të anëtarëve të Komisionit për kandidaten 1/5 faqe; Vendim me numër 14-101/03-128609/2023 i datës 21.06.2023 i Kryetarit të Komunës së Prishtinës;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pabazuar, sepse:

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr vendimin me numër A.nr.631/2023 me datë 09.06.2023 me numër protokolli 4663/2023 me të cilin ka Aprovuar ankesën A.nr.631/2023 e datës 12.04.2023, e parashtruar nga ankuesja Ariana Lukaj dhe Anulohet Konkursi për pranim me nr. Reference RN00011416 me emrin e grupit Specialist të marrëdhënieve me publikun për informim-"Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun" i shpallur me datë 06.04.2023 nga Komuna e Prishtinës, si dhe çdo veprim tjetër administrativ që rrjedhë nga kjo procedurë e pranimi. Anulohet Vendimi i datës 31.03.2023 i Komisionit të Vlerësimit, Renditja përfundimtare e kandidatëve e datës 23.03.2023 si dhe Njoftimi i datës 31.03.2023 për përfundimin e procedurës së lëvizjes brenda kategorisë me numër reference RN0001101 për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun". Mbetet në Fuqi Konkursi për Lëvizje brenda kategorisë me numër reference RN00011001, për pozitën e punës "Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun" në Komunën e Prishtinës si dhe Njoftimi për përzgjedhjen në listën e ngushtë i datës 13.03.2023, ndërsa çështja kthehet në fazën e vlerësimit të Komisionit për Vlerësim për lëvizje brenda kategorisë. Dhe Obligohet Kryetari i Komunës së Prishtinës dhe Udhëheqësi i Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Prishtinës, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimi të këtij vendimi, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme me qëllim të zbatimit të këtij vendimi siç përcaktohet në pikën II, III dhe IV të dispozitivit.

Me qëllim të zbatimit të vendimit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës A.nr.631/2023 të datës 09.06.2023, Kryetari i Komunës së Prishtinës ka nxjerr

Vendim me numër 14-101/03-128609/2023 me datë 21.06.2023 me të cilin ka zbatuar vendimin e Këshillit A.nr.631/2023 të datës 09.06.2023 me numër protokolli 4663/2023.

Kolegji i Këshillit ka konstatuar se ankuesja në bazë të Renditjes përfundimtare për pozitën *“Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun”* në Komunën e Prishtinës të datës 28.08.2023, pas rivlerësimit komisioni i vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë ankuesen e ka vlerësuar me 22.4 pikë. Ndërsa Sektori i Burimeve Njerëzore me datë 28.08.2023 ka nxjerr Njoftimin me të cilin Komisioni vlerësues pas përfundimit të procedurës së intervistës, ka konstatuar se asnjë kandidatë nuk kalon andaj konkursi dështon. Ankuesja e pakënaqur me datë 01.09.2023 brenda afatit ligjor ka parashtruar ankesë tek Komisioni i Vlerësimit për lëvizje brenda kategorisë me kërkesën që të anulohet njoftimi i datës 28.08.2023 i Sektorit të Burimeve Njerëzore të Komunës së Prishtinës dhe të zbatohet vendimi me numër A.nr.631/2023 i datës 09.06.2023. Ndërsa me datë 26.09.2023 U.d. Menaxheri i Komunës së Prishtinës e ka njoftuar se vendimi i Këshillit është zbatuar në tërësi.

Ankuesja e pakënaqur, ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Njoftimit të Komisionit Vlerësues të datës 28.08.2023 të Komunës së Prishtinës me pretendimin se nuk pajtohet me vlerësimin e bërë nga ana e Komisionit Vlerësues.

Në kuptim të vendosjes meritore lidhur me këtë çështje juridiko-administrative, Kolegji i Këshillit, i'u referua dispozitave të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkitazi me rregullimin e procedurës dhe përgjegjësinë disiplinore të nëpunësve civil, konkretisht Kolegji analizoj: Nenin 38 paragrafi 1 dhe 2, me të cilin është përcaktuar se: *“1. Plotësimi i pozitave të lira në kategorinë profesionale, të ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari nga nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, nëpërmjet procedurës së lëvizjes brenda kategorisë. 2. Nëpunësit civilë të së njëjtës kategori në kuadër të Shërbimit Civil, që i plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e posaçme për vendin e lirë, mund të aplikojnë për plotësimin e një vendi të lirë, nëpërmjet procedurës së lëvizjes, sipas paragrafit 1 të këtij neni”*.

Nenin 38 paragrafi 5 dhe 6, me të cilin është përcaktuar se: *“5. Vlerësimi i kandidatëve të interesuar kryhet nga një komision vlerësimi, i krijuar në çdo institucion, bazuar në një intervistë me kandidatët. Komision përbëhet nga pesë anëtarë, njëri nga të cilët është domosdo përfaqësues i Njesisë së Burimeve Njerëzore të institucionit. 6. Në përfundim të vlerësimit, Komisioni mund të vendosë: 6.1. përzgjedhjen e kandidatit më të suksesshëm për t'u emëruar në vendin e lirë, apo; 6.2. përfundimin e procedurës, pa asnjë të përzgjedhur, në rast se asnjë nga kandidatët e interesuar nuk vlerësohet i suksesshëm për atë vend të lirë të punës.”*. Po ashtu Kolegji i Këshillit ju referua dispozitave të Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, përkatësisht: Nenit 44 paragrafi 1 dhe 2, me të cilin është përcaktuar se: *“1.Konkurimi për lëvizjen brenda kategorisë zhvillohet në dy faza: 1.1. verifikimi paraprak i kandidatëve; dhe 1.2. vlerësimi i kandidatëve. 2.Verifikimi paraprak kryhet nga NJBNJ, ndërsa vlerësimi i kandidateve kryhet nga Komisioni i Vlerësimit për lëvizjen brenda kategorisë, krijuar sipas nenit 47 të kësaj Rregulloreje”* Nenit 45 paragrafi 1, 2 dhe 3, me të cilin është përcaktuar se: *“1.Verifikimi paraprak është procesi i verifikimit nëse kandidati plotëson kushtet për lëvizjen brenda*

kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë për të cilën konkurohet. 2.Verifikimi paraparak kryhet nga NJBNJ. 3.Në përfundim të verifikimit paraparak NJBNJ përcakton kandidatët që plotësojnë kushtet për lëvizjen brenda kategorisë dhe kërkesat e veçanta për pozitën e lirë. Vetëm këta kandidatë kanë të drejtë të vazhdojnë më tej konkurrimin". Nenit 47 paragrafi 1, 2, 3 dhe 4, me të cilin përcaktohet se: "1.KVLBK zhvillon një intervistë me gojë me kandidatët. 2.Nëpërmjet intervistës, KVLBK vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi. 3.KVLBK përgatit përpara fillimit të intervistës një grup pyetjesh. Intervista që zhvillohet është e strukturuar dhe me pyetje të njëjta për të gjithë kandidatët e cila përgatitet në ditën e zhvillimit të intervistës.. 4.Vlerësimi maksimal në intervistën me gojë është njëqind (100) pike". Nenit 48 paragrafi 1 dhe 2, me të cilin përcaktohet se: "...Pikët e çdo anëtari për çdo vlerësim mbledhen dhe pjesëtohen me pesë. 2.Në përfundim të fazës të vlerësimit, pikët e përfituara nga secili kandidat në secilën nga hapat e vlerësimit, mbledhen dhe shuma e pikëve për të gjithë hapat e vlerësimet përbën vlerësimin përfundimtar të konkurrimit".

Nenit 49 paragrafi 1, 2 dhe 3, me të cilin përcaktohet se: "1.KVLB në përfundim të fazës së vlerësimit të kandidatëve, harton dhe miraton një listë me vlerësimet përfundimtare të të gjithë kandidatëve. Kandidatët renditen në listë sipas rezultatit të vlerësimit përfundimtar në rendin zbritës. Lista i dërgohet Njësisë Përgjegjëse brenda njëzetë e katër (24) orëve nga miratimi i saj. 2.Kandidati që është vlerësuar me më shumë pikë dhe që ka marrë të paktën gjashtëdhjetë (60) pikë është kandidati fitues dhe ka të drejtën të emërohet në pozitën e lirë për të cilën është zhvilluar konkurimi. 3.Nëse asnjë nga kandidatët nuk është vlerësuar me gjashtëdhjetë 60 e më shumë pikë, procedura e lëvizjes brenda kategorisë përfundon pa kandidat fitues".

Bazuar në dispozitat e lartcekura, Kolegji i Këshillit, konstaton se Komisionit për Vlerësimin e lëvizjes brenda kategorisë, nëpërmjet intervistës, vlerëson jetëshkrimin/CV, njohuritë, aftësitë apo cilësitë e kërkuara për pozitën e punës për të cilën zhvillohet konkurrimi, rrjedhimisht me asnjë dispozitë ligjore për procedurat e lëvizjes brenda kategorisë sipas Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores (QRK) Nr.16/2020 për Pranimin dhe Karrierën në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nuk është përcaktuar që vlerësimi i jetëshkrimit apo CV-së bëhet ndaras por kjo bëhet gjatë vlerësimit të intervistës me gojë respektivisht ky vlerësim inkorporohet në pikët e vlerësimit me gojë, mbi këtë bazë Kolegji i Këshillit, vlerëson se Komisioni për Vlerësimin e Lëvizjes Brenda Kategorisë në Komunën e Prishtinës, vlerësimin e intervistës me gojë për kandidatët në këtë proces e ka bërë në pajtim me dispozitat e lartcekura, rrjedhimisht ankuesja nga komisioni është rivlerësuar me gjithsejtë 22.4 pikë që kanë qenë të pamjaftueshme për emërim. Pas përfundimit të procedurave Komuna e Prishtinës konkretisht Njësia për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore ka nxjerr Njoftim lidhur me konkursin e publikuar me datë 31.08.2023, për konkursin me numër reference RN00011001 për pozitën "Zyrtar i Lartë për Komunikim me Publikun" për lëvizje brenda kategorisë në Komunën e Prishtinës, me të cilin Komisioni vlerësues pas përfundimit të procedurës së intervistës, ka konstatuar se asnjë kandidatë nuk kalon andaj konkursi dështon.

Duke marr parasysh të gjitha shkresat e lëndës dhe provat e bashkëngjitura në lëndë, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1215/2023

Çlirim Zeka


Procesmbajtës



Vendimi i dorëzohet:

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankueses avokatit
- Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Prishtinës dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së;